



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 422/5 prot.

Tiranë, më 03.4 .2021

VENDIM

Nr. 22 , datë 09/4 /2021

PËR
RISHIKIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës c), d) dhe e) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, neneve 135 – 147 të Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), në përputhje me shkronjën e) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas së cilës Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), ka kompetencë monitorimin e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), ka kryer monitorimin on-line të transparencës proaktive të Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, në përfundim Komisioneri vlerësoi se është shkelur detyrimi për vënien në zbatim të Programit Model të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 14, datë 22.01.2015, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës” të Komisionerit, mosveprim i cili konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën “b”, pika 2 e nenit 18 të LDI, dhe nëpërmjet Vendimit nr. 9, datë 02.03.2021, vendosi:

1. Autoriteti Publik “Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, në zbatim të gërmave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të vendosë në zbatim Programin Model të Transparencës në përputhje me urdhrin nr.14, datë 22.01.2015 “Për miratimin e

Programit Model të Transparencës” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndryshuar me Urdhër nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës”, të rishikuar;

2. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik znj. Jetmira Bebeçi, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 1 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Kundër Vendimit nr. 9 datë 02.03.2021 “Për Urdhërimin e Autoritetit Publik” të Komisionerit, me shkresën nr. 174/5 Prot., datë 08.03.2021, titullari i Autoritetit Publik, ka paraqitur kërkesë me objekt revokimin/shfuqizimin e vendimit të sipërcituar.

Në kërkesën e paraqitur znj. Bebeçi argumenton se: “...Drejtuesi i institucionit është ndryshuar me datë 05.01.2021 dhe është autorizuar të ushtrojë përkohësisht detyrat e Drejtorit të Agjencisë znj. Jetmira Bebeçi.

Zyra e Komisionerit me shkresën nr.74Prot., datë 12.01.2021, me objekt “Dërgohet programi i transparencës dhe regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, i përditësuar”, ka lënë afat deri me datë 31.03.2021.

Në shkresën nr.213 Prot., datë 27.01.2021 me objekt “Për hetimin administrativ lidhur me programin e transparencës”, është kërkuar përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ka kërkuar kohë deri në datën 15.02.2021, si dhe ka njoftuar nëpërmjet e-mail-it, për fillimin e punës për implementimin e programit”.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik kërkon rishikimin e vendimit dhe shfuqizimin e masës administrative.

Në pikën 2, të nenit 144 të Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “KPrA”), e parashikohet se: “Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ”.

Bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura nga ana e Autoritetit Publik, rezulton se titullari i Autoritetit Publik znj. Jetmira Bebeçi, është autorizuar të ushtrojë përkohësisht detyrat e Drejtorit të autoritetit publik në datën 05 Janar 2021, ndërkohë monitorimi i programit të transparencës së Autoritetit Publik, është kryer nga ana e Zyrës së Komisionerit në periudhën dhjetor 2020.

Po ashtu, nga verifikimi on-line i faqes zyrtare të Autoritetit Publik, konstatohet se Autoriteti Publik nuk vijon të jetë në të njëjtat kushte, me ato të konstatuara gjatë nxjerrjes së vendimit, në lidhje me publikimin e programit të transparencës.

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Autoritetit Publik, Zyra e Komisionerit konstaton se Autoriteti Publik ka implementuar formatin e ri të programit të transparencës, sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” të Komisionerit, si dhe ka plotësuar pjesërisht programin me informacionin i cili duhet të jetë publik.

Në përfundim, pas shqyrtimit të kërkesës me objekt “Revokimin/Shfuqizimin e Vendimit nr. 9 datë 02.03.2021” të Komisionerit, provave dhe argumenteve të paraqitura, Komisioneri çmon se ka vend për pranimin pjesërisht të kërkesës së paraqitur për revokimin/shfuqizimin e Vendimit nr. 9 datë 02.03.2021 “Për Urdhërimin e Autoritetit Publik” të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 146 të Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S A:

1. Rishikimin e Vendimit nr. 9, datë 02.03.2021, “Për Urdhërimin e Autoritetit Publik” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke anuluar pikat 2 dhe 3 të tij, konkretisht “2. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik znj. Jetmira Bebeçi, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 1 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit 3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit”.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 9, datë 02.03.2021, “Për Urdhërimin e Autoritetit Publik” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përsa i përket pjesës tjetër të dispozitivit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 09. 4 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

